



## VENDIMI DHE GJETJET

**Data e miratimit: 19 tetor 2016**

**Numri i lëndës: 2014-11, 2014-12, 2014-13, 2014-14, 2014-15, 2014-16  
dhe 2014-17**

**D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R.**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 19 tetor 2016, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese

Z. Guénaël METTRAUX, anëtar

Znj. Elka ERMENKOVA, anëtare

Ndihmuar nga

Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

## PROCEDURA

1. Kryesuesja e Panelit, znj. Magda Mierzewska, ka marrë pjesë në shqyrtimin e kësaj lënde përmes komunikimit elektronik në përputhje me nenin 13(3) të rregullores së punës së Panelit.
2. Ankesat janë regjistruar përkatësisht në këto data:
  - ankesat nr. 2014-11 deri te 2014-14 me 11 mars 2014;
  - ankesa nr. 2014-15 me 17 mars 2014; dhe
  - ankesat nr. 2014-16 dhe 2014-17 me 19 mars 2014.

3. Të gjithë ankuesit përveç njërit kanë kërkuar që identiteti i tyre mos të bëhet publik. Në bazë të natyrës së ankesave, Paneli i pranoj këto kërkesa.
4. Me 27 maj 2014, Paneli ka vendosur ta njoftonte rreth ankesave shefin e Misionit (ShM) të EULEX-it Kosovë, duke e ftuar atë të paraqes vërejtje me shkrim për ankesat. Gjithashtu Paneli vendosi të shqyrtoj meritat e aplikacionit në të njëjtën kohë me pranueshmërinë e tij (në pajtim me rregullën 30, paragrafët 1 dhe 2 të rregullores së punës).
5. Vërejtjet e ShM-së janë pranuar me datën 1 tetor 2014, e pas kësaj ato i janë komunikuar ankuesve për vërejtje shtesë.
6. Me 24 nëntor 2014, ankuesit dërguan vërejtjet e tyre shtesë, të cilat njëra pas tjetrës u janë dërguar ShM-së për informim.
7. Me 30 shtator 2015, Paneli ka shpallur të pranueshme ankesën. Paneli ka konstatuar se ankesa ka ngritur çështje serioze të fakteve dhe të ligjit në bazë të nenit 2 (e drejta për jetën), 3 (ndalimi i torturës, trajtimit çnjerëzor ose poshtërues), 8 (respektimi i jetës private) dhe 13 (e drejta për mjete efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("Konventa") për përcaktimin e të cilave është kërkuar një shqyrtim i bazueshmërisë së ankesës. Paneli ka ftuar palët të paraqesin ndonjë vërejtje shtesë që ata kanë rreth meritave të lëndës.
8. Vërejtjet nga shefi i Misionit dhe ankuesi janë pranuar me 2 mars 2016 dhe përkatësisht me 25 prill 2016.
9. Duke pasur parasysh karakterin e veçantë të ankesave dhe përplasjen e madhe të çështjeve të ngritura në këto lëndë me njëra tjetren, Paneli përmes kësaj urdhëron bashkimin formal të këtyre shtatë lëndëve (2014-11 deri 2014-17), në pajtim me rregullën 20 të rregullores së punës.

## **FAKTET**

### **I. RRETHANAT E LËNDËVE**

10. Të gjithë ankuesit janë të përkatësisë serbe dhe janë të përfaqësuar nga e njëjta avokate, znj. Jovanka Stojasavljevic-Savic.

### **Lënda 2014-11, D.W.**

11. Me 16 qershori 1999, A.W. dhe BW, bashkëshorti dhe djali i ankueses ishin duke vizituar shtëpinë e tyre familjare në Obiliq. Më pas, ankuesja (D.W.) ka dëgjuar të shtëna armësh që vinin nga drejtimi i shtëpisë së saj.

12. Me 20 qershor 1999, ankuesja ishte njoftuar se bashkëshorti dhe djali i saj ishin gjetur të vdekur. Ajo më vonë kuptoj se ata ishin varrosur në një varr të pashënuar. Më vonë, trupat e A.W. dhe B.W. janë gjetur dhe identifikuar nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar dhe i janë kthyer ankueses pér varrim.
13. Me 9 prill 2009, ankuesja ka parashtruar ankesë në Panelin Këshillëdhënës pér të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut (PKDNj). Ajo pohoj se UNMIK-u ka dështuar që të hetonte si duhej vrasjen e bashkëshortit dhe djalit të saj dhe prandaj të drejtat e saj ishin shkelur. Me 6 qershor 2013, PKDNJ-ja konstatoj se kishte pasur shkelje të të drejtave të ankueses sipas nenit 2 të Konventës Evropiane pér të Drejtat e Njeriut.
14. Me 11 qershor 2013, përfaqësuesi ligjor i ankueses ka dërguar një letër në EULEX, ku ka pyetur nëse ata kishin ndonjë të dhënë në lidhje me A.W. dhe B.W. dhe disa persona të tjerë. Me 12 korrik 2013, shefi i Zyrës së Prokurorisë Speciale (PSRK) u përgjigj se në bazë të nenit 63 par. 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), pala e dëmtuar mund të përfaqësohet vetëm nga një person i cili është anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës, kështu që të dhënat nuk mund t'i ofrohen përfaqësuesit të ankuesve që nuk ishte pjesë e Odës së Avokatëve të Kosovës.
15. Me 18 korrik 2013, ankuesja tërroqi vëmendjen e shefit të PSRK-së në nenit 63 par. 3 të KPP-së, që parashikon se pala e dëmtuar mund të përfaqësoj veten. Ajo përsëriti kërkesën e saj që informatat mbi të afërmit e saj t'i ofrohen dhe kërkoj që ato t'i dërgohen në adresën e avokatit të saj.
16. Me 9 tetor 2013, ankuesja ka marrë një letër nga shefi i PSRK-së. Ajo u informua se hetimi ishte mbyllur, pasi autori i krimtit nuk ishte mundur të identifikohej (*"një aktvendim pér refuzimin e kallëzimin penal të datës 20 korrik 2009 është lëshuar nga një prokuror i EULEX-it pasi [doli] [...] që prej kallëzimit penal nuk kishte asnje dyshim të arsyeshëm kundër ndonjë të të dyshuarit të veçantë"*). Letra më tej e informoj atë se ishte lëshuar një njoftim pér mbylljen e hetimeve dhe se pala e dëmtuar ka qenë e informuar pér të drejtën që të procedoj me ndjekjen penale si paditës dytësor brenda tetë ditëve nga marrja e njoftimit pér refuzim. Sipas letrës, kërkohej me ligj që vendimi dhe njoftimi t'i dorëzoheshin familjes së viktimës. Në të njëjtën letër, ankuesja ishte informuar se përfaqësuesi i saj do të lejohej që të hetoj të dhënat e EULEX-it rrëth lëndës së saj. Ajo pohon se nuk ishte në gjendje të organizoj një takim me EULEX-in pér këtë qëllim.
17. Ankuesja tregon se zyrtarisht asnjëherë nuk iu është dorëzuar asaj vendimi pér refuzimin e kallëzimit penal.

18. Bashkëshorti i ankueses, S.V., ishte sulmuar në banesën e tij në Prishtinë me 5 korrik 1999. Ai vdiq si rezultat i plagëve gjatë rrugës për në spital.
19. Më vonë në vitin 2000, ankuesja ishte intervistuar nga një person, i cili ajo beson se i përkiste “forcës së policisë ndërkombëtare” dhe i cili i siguroj asaj se po zhvillohej një hetim. Asaj nuk i është dhënë asnjë dokument nga zyrtari në fjalë dhe as hollësitë e kontaktit dhe që prej atëherë nuk ka dëgjuar asgjë.
20. Me 12 korrik 2013, në përgjigje të pyetjeve nga përfaqësuesi i ankuesit, shefi i PSRK-së e informoj atë se ai nuk mund t'i zbuloj asaj asnjë informacion, pasi ajo nuk ishte anëtarë e Odës së Avokatëve të Kosovës.
21. Me 18 korrik 2013, E.V. ka kërkuar që të dhënat në lidhje me vdekjen e bashkëshortit të saj t'i përcillen në adresën e avokatit të saj.
22. Përkundër kërkesave të përsëritura, asnjë përgjigje tjetër nuk ishte marrë nga PSRK-ja.
23. Në parashtrimet e tij, ShM-ja bëri të qartë se EULEX-i nuk posedon asnjë dosje lidhur me vrasjen e bashkëshortit të ankueses. Megjithatë ata kanë qasje në Arkivin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë. Duket se dokumentet janë dorëzuar nga UNMIK-u tek autoritetet e Kosovës lidhur me këtë lëndë me 22 gusht 2008. Gjithashtu nga të dhënat duket se me 6 shkurt 2009, prokurori publik i Kosovës hodhi poshtë kallëzimin penal mbi rastin, mbi bazën se nuk ka pasur dyshim të arsyeshëm kundër asnjë të dyshuar të veçantë.

#### **Lënda 2014-13, F.U.**

24. Me 30 qershor 1999, bashkëshorti i ankueses, A.U. ishte qëlluar për vdekje në pragun e shtëpisë së të afërmit të tyre në Obiliq, gjoja nga persona me emblemë të UÇK-së.
25. KFOR-i britanik ishte në vendin e ngjarjes dhe ka përgatitur një raport rreth incidentit, duke shënuar se kishin intervistuar disa “të afërm” dhe anëtarë të familjes së ankueses.
26. Megjithatë, as raporti e as ndonjë dokument tjetër nuk i është dorëzuar familjes. Ankuesja nuk ka marrë asnjë informacion tjetër në lidhje me vdekjen dhe rrethanat e vdekjes së bashkëshortit të saj.
27. Me 1 dhjetor 1999, Policia e UNMIK-ut ka intervistuar katër dëshmitarë në lidhje me këtë rast. Në raportin e tyre përfundimtar, Policia ka sugjeruar se hetimi duhet të mbyllej për shkak të mungesës së informacionit rreth të dyshuarve të mundshëm. Në raportin e UNMIK-ut lidhur me reportin e rastit të vitit 2003, statusi i lëndës është

i regjistruar i mbyllur. Nuk ka asnje informacion nese familja e viktimes ishte informuar.

28. Me 12 korrik 2013, ne përgjigje të pyetjeve nga përfaqësuesi i ankueses, shefi i PSRK-së e informoi atë se nuk mund t'i zbulonte asnje informacion, pasi ajo nuk ishte anëtare e Odës së Avokatëve të Kosovës.
29. Me 18 korrik 2013, ankuesja ka kërkuar që ato të dhëna që kishin të bënин me vdekjen e bashkëshortit të saj t'i përcilleshin në adresën e avokatit të saj.
30. Me 20 shtator 2013, shefi i PSRK-së ka informuar ankuesen se vendimi për të hedhur poshtë kallëzimin penal të datës 20 korrik 2009 ishte lëshuar nga një prokuror i EULEX-it "pasi [doli] [...] që prej kallëzimit penal nuk kishte asnje dyshim të arsyeshëm ndaj ndonjë të dyshuar të veçantë". Letra më tej e informoj atë se ishte lëshuar një njoftim për mbylljen e hetimeve dhe se pala e dëmtuar ka qenë e informuar për të drejtën që të vazhdoj me ndjekjen penale si paditës dytësor. Ajo gjithashtu u informua se përfaqësuesi i saj do të lejohej të hetoj të dhënat e EULEX-it rreth rastit të saj. Ajo pohon se nuk ishte në gjendje të siguroj një takim me EULEX-in për këtë qëllim.
31. Ankueses asnjeherë nuk ju është dhënë zyrtarisht vendimi i refuzimit të kallëzimit penal.

#### **Lënda 2014-14, G.T.**

32. Me 27 korrik 1999, B.T., djali i ankueses ishte vrarë nga persona të panjohur në një rrugë afér Vushtrrisë. KFOR-i britanik kishte dalë në vendin e ngjarjes, por ankueses nuk i ishte kërkuar të jepë informacion personal ose dëshmi dhe që atëherë nuk ka dëgjuar ndonjë gjë nga KFOR-i.
33. Me 18 korrik 2013, ankuesja ka dërguar një letër tek shefi i PSRK-së, duke e pyetur nese ata kishin ndonjë të dhënë në lidhje me vdekjen e djalit të saj. Ajo ka kërkuar që të dhënat në lidhje me vdekjen e djalit të saj të përcillen në adresën e avokatit të saj.
34. Me 19 shtator 2013, shefi i PSRK-së u përgjigji se, pavarësisht nga ndonjë hulumtim tërësor i kryer nga Njësia e Policisë për Hetimin e krimeve të luftës (NJHKL) të PSRK-së, nuk ishte gjeturasnje e dhënë lidhur me rastin e vdekjes së djalit të saj.

#### **Lënda 2014-15, Zlata Veselinović**

35. Sipas ankueses, bashkëshorti i saj, S.V. ishte qëlluar për vdekje në Prizren me 13 qershor 1999 nga ushtarët e KFOR-it gjerman. Ajo nuk i di rr Ethanat e sakta rreth vdekjes së tij dhe ajo ka pohuar se kërkesa

e saj për certifikatë të vdekjes dhe informacion në lidhje me rrethanat e vdekjes së bashkëshortit të saj mbeten pa përgjigje.

36. Me 18 korrik 2013, ankuesja i ka dërguar një letër shefit të PSRK-së, duke e pyetur nëse ata kishin ndonjë të dhënë në lidhje me vdekjen e bashkëshortit të saj. Ajo ka kërkuar që të dhënat në lidhje me vdekjen e bashkëshortit të saj të përcillen në adresën e avokatit të saj.
37. Me 17 shtator 2013, shefi i PSRK-së u përgjigj se PSRK-ja nuk mund të gjej ndonjë të dhënë lidhur me vdekjen e bashkëshortit të ankueses. Megjithatë ajo u informua se NJHKL-ja kishte gjetur se S.V. paraqitej në listën e personave të zhdukur të Komisionit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq.

#### **Lënda 2014-16, H.S.**

38. Vëllai i ankuesit, A.S. ishte qëlluar jashtë shtëpisë së tij në fshatin Batushë me 8 korrik 1999 dhe kishte vdekur si pasojë e lëndimeve. Familja e tij nuk ishte marrë në pyetje, e as të dhënat e tyre personale nuk ishin marrë nga KFOR-i.
39. Me 18 korrik 2013, ankuesi ka dërguar një letër shefit të PSRK-së, duke pyetur nëse kishin ndonjë të dhënë në lidhje me vdekjen e vëllait të tij. Ai kërkoj që të dhënat në lidhje me vdekjen e vëllait të tij të përcillen tek ai në adresën e avokatit të tij.
40. Në një letër të datës 20 shtator 2013, shefi i PSRK-së informoj ankuesin se pavarësisht hulumtimit të plotë të kryer nga PSRK-ja dhe NJHKL-ja, nuk ishte gjetur asnjë e dhëna në lidhje me rastin e vdekjes së vëllait të tij.

#### **Lënda 2014-17, I.R.**

41. Bashkëshorti i ankueses ishte qëlluar për vdekje në periferi të Bërnicës së Ulët me 11 mars 2000.
42. Me 29 mars 2000, ankuesja ka marrë një memorandum nga një hetues i njësisë së hetimeve rajonale të UNMIK-ut. Ajo u informua se rasti i vdekjes së bashkëshortit të saj ishte nën hetime dhe se asnjë i dyshuar nuk ishin identifikuar në atë fazë.
43. Me 18 korrik 2013, ankuesja i dërgoi një letër shefit të PSRK-së, duke pyetur nëse ata kishin ndonjë të dhënë në lidhje me vdekjen e bashkëshortit të saj. Ajo ka kërkuar që të dhënat në lidhje me vdekjen e bashkëshortit të saj t'i përcillen asaj në adresën e avokatit të saj.
44. Me 19 shtator 2013, shefi i PSRK-së ka informuar ankuesin se pavarësisht nga hulumtimi i plotë i kryer nga PSRK-ja dhe NJHKL-ja, nuk ishin gjetur të dhëna në lidhje me rastin e bashkëshortit të saj.

45. Me 31 tetor 2013, përfaqjësuesi ligjor i ankueses i ka dërguar shefit të PSRK-së memorandumin e UNMIK-it të datës 29 mars 2000 (shih par. 39 më lartë) dhe i ka kërkuar atij që të rishikoj pozicionin e tij në bazë të informacionit që ai përmban. Ankuesi nuk ka marrë asnje përgjigje rreth këtij hetimi.

## II. ANKESAT

46. Ankuesit i referohen dy të drejtave të veçanta themelore që garantohen në dispozitat e mëposhtme: Neni 2 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa) nën pjesën e tij procedurale, e cila garanton të drejtën themelore të personit për jetë dhe parashevë obligimin për të hetuar rastet e vdekjeve të dyshimta; Neni 3 i Konventës, i cili garanton të drejtën e personit për të mos iu nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.

## II. LIGJI PËRKATËS NË FUQI

### Veprimi i Përbashkët

**VEPRIMI I PËRBASHKËT I KËSHILLIT 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 mbi Misionin për Sundimin e Ligjit Evropian në Kosovë, EULEX-i KOSOVË**

#### Neni 2 Deklarata e Misionit

EULEX-i KOSOVË do t'i ndihmoj institucionet e Kosovës, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin ligjit në përparimin e tyre drejt stabilitetit dhe besueshmërisë në zhvillimet e mëtutjeshme dhe forcimin e sistemit të pavarur shumetnik të drejtësisë, të polisë, të doganës duke siguruar që këto institucione nuk do të ndikohen politikisht dhe do t'ju përbahen standardeve të pranuara ndërkombëtare dhe praktikave më të mira evropiane.

#### Neni 3 Detyrat

Me qëllim të përbushjes së Deklaratës së Misionit të përcaktuar në nenin 2, EULEX-i KOSOVË do të:

(...)

(h) merr përgjegjësi të tjera, qoftë ndarazi apo në bashkëpunim me autoritetet kompetente të Kosovës, për të siguruar zbatimin dhe promovimin e sundimit të ligjit, të rendit publik dhe sigurisë, në konsultim me agjencitë përkatëse të Këshillit; dhe

### Ligji mbi kompetencat

**Ligji Nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në KOSOVË (në fuqi deri më 30 maj 2014)**

### **Neni 3 Juridiksioni dhe kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it në procedurë penale**

(...)

3.3. Para fillimit të fazave përkatëse të procedurës dhe pas kërkesës së prokurorit të EULEX-it të caktuar në lëndë apo që punon në ekipin e përzier të identifikuar në nenet 9 dhe 10 të këtij ligji apo pas kërkesës së cilësdo palë në procedurë, apo pas kërkesës me shkrim të kryetarit është gjykatës kompetente apo të seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme të Kosovës kur nuk zbatohen dispozitat lidhur me përjashtmin e një gjyqtari apo një gjyqtari porotë të paraparë sipas KPPPK-së (neni 40-44 i KPPPK-së), kryetari i asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it do të ketë kompetencë, çdoherë kur konsiderohet e nevojshme që të sigurohet administrimi i duhur i drejtësisë, që t'i caktoj gjyqtarët e EULEX-it në fazën përkatëse të një procedure penale në përputhje me modalitetet përfshirë përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të përcaktuara nga asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it dhe në pajtim me këtë ligj, për krimet e poshtëshënuara, atëherë kur hetimi a ndjekja penale nuk kryhen nga PSRK-ja:

(...)

h) shkelja e statusit të barabartë të banorëve të Kosovës (neni 158, KPPK)

### **Neni 12 Kompetencat e prokurorëve të EULEX-it në rast të mosgatishmërisë apo paaftësisë së prokurorëve publik të Kosovës**

12.1 Në çdo fazë të çdo procedure penale, nëse një prokuror publik i Kosovës nuk është i gatshëm apo është i paaftë që të ushtroj detyrat e tij dhe kjo mosgatishmëri apo paaftësi mund të rrezikoj hetimin apo ndjekjen e duhur të një vepre penale, apo kurdoherë që ekziston dyshimi i bazuar se bëhen përpjekje përfshirë ndikuar në hetimin apo ndjekjen e një vepre penale, kryeprokurori i EULEX-it ka kompetencë që të kërkoj nga kryeprokurori i zyrës kompetente që atë lëndë t'ia caktoj: a) një prokurori tjetër publik të Kosovës që punon në të njëjtën zyre prokuroriale, b) apo cilindro prokuror të EULEX-it që do të marrë përgjegjësinë përfshirë hetimin apo ndjekjen penale përkatëse.

12.2 Nëse kryeprokurori i zyrës kompetente kundërshton kërkesën e kryeprokurorit të EULEX-it, kryeprokurori i EULEX-it do ta njoftoj kryeprokurorin publik të Kosovës dhe së bashku do të marrin një vendim të përbashkët i cili do të respektohet nga kryeprokurori i zyrës kompetente.

12.3 Në rrethana urgjente ose kur vonesa mund të ndikoj në kryerjen apo rezultatin e hetimit, ndjekjes penale apo zhvillimit të drejtë të procedurës, kryeprokurori i EULEX-it do të ketë të drejtë që të ndërmerr çfarëdo veprimi urgjent procedural apo të caktoj cilindro prokuror të EULEX-it apo prokuror publik të Kosovës përfshirë qëllim të tillë.

*Ligji Nr. 04/L-273 përfshirë plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian përfshirë sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës (në fuqi prej 31 majit 2014)*

### **Neni 3 Përfshirë plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it Kosovë**

.....

3. Pas nenit 1 të ligjit bazik, shtohet një nen i ri 1.A me tekstin si në vijim:

Neni 1.A Rastet në proces

Për qëllime të këtij ligji, rast në proces nënkuption:

1. Rastet për të cilat vendimi për fillimin e hetimeve është dhënë para datës 15 prill 2014 nga prokurorët e EULEX-it në pajtim me ligjin;
2. Rastet të cilat u janë caktuar gjyqtarëve të EULEX-it para datës 15 prill 2014.

.....

9. Neni 7 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 7 Autoriteti dhe kompetencat e përgjithshme të prokurorëve të EULEX-it

7.1. Prokurorët e EULEX-it do të kenë autoritet dhe përgjegjësi t'i kryejnë funksionet e tyre, përfshirë autoritetin për kryerjen e hetimeve penale ashtu si përcaktohet në nenin 2.1 të këtij ligji, përvèç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj.

7.2. Prokurorët e EULEX-it do të janë kompetentë për hetimin dhe ndjekjen penale te krimeve që janë në kompetencë të PSRK-së në pajtim me ligjin mbi PSRK-në.

7.3. Prokurorët e EULEX-it janë të integruar në sistemin prokurorial të Kosovës dhe do të ushtrojnë funksionet e tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

7.4. Rastet e udhëhequra nga prokurorët e EULEX-it të përcaktuara në nenin 2.1 të këtij ligji do të vazhdojnë të menaxhohen në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi juridikcionin, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (2008) dhe të Ligjit për PSRK-në (2008).

7.5. EULEX-i KOSOVË do të caktoj prokurorë që të ndihmojnë lidhur me zbatimin, sipas marrëveshjes, të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të lehtësuar nga BE-ja.

7.6. Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, prokurorët e EULEX-it do t'i bashkërendojnë aktivitetet e tyre me kryeprokurorin përgjegjës për zyrën të cilën ata janë të vendosur.

.....

10. Pas nenit 7 të ligjit, shtohen dy nene të reja 7.A dhe 7.B me tekstin si në vijim:

Neni 7.A Autoriteti i prokurorëve të EULEX-it në rrethana të jashtëzakonshme

Në rrethana të jashtëzakonshme, një rast mund t'i caktohet në prokurori të EULEX-it nga një vendim i përbashkët i kryeprokurorit të shtetit dhe autoritetit kompetent të EULEX-it KOSOVË.

*Ligji Nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës*

Neni 5 Kompetenca e veçantë e PSRK-së

5.1 PSRK-ja do të ketë kompetencë të veçantë që të hetoj dhe ndjek penalist krimet, edhe të atyre në formë të tentimit, dhe format e ndryshme të bashkëpunimit në krim si vijon:

- .....  
e) krimet kundër njerëzimit (neni 117, KPPK);  
f) krimet e luftës në kundërshtim të rëndë me konventat e Gjenevës (neni 118, KPPK), krimet e luftës si shkelje e rëndë e ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktin e armatosur ndërkombëtar (neni 119, KPPK), krimet e luftës për shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët me konventat e Gjenevës (neni 120, KPPK), krimet e luftës të cilat paraqesin shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë në karakterit ndërkombëtar (neni 121, KPPK);  
...  
n) krimi i organizuar (neni 274, KPPK), kërcënimi gjatë procedurave penale për krim të organizuar (neni 310, KPPK);  
.....

Neni 9 Kompetenca plotësuese e PSRK-së

9.1 PSRK-ja do të ketë kompetencë plotësuese, sipas modaliteteve të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, për të hetuar dhe ndjekur penalist krimet, edhe të atyre në formë të tentimit, dhe format e ndryshme të bashkëpunimin në krim si në vijon:

- .....  
b) nxitia e urrejtjes, e përçarjes ose e mos durimit kombëtar, racor, fetar a etnik (neni 115, KPPK);  
.....  
h) vrasja (neni 146, KPPK), vrasja e rëndë (neni 147, KPPK);  
i) marrja e pengjeve (neni 143, KPPK);  
j) shkelja e statusit të barabartë të banorëve të Kosovës (neni 158, KPPK);  
k) rrëmbimi i personit (neni 159, KPPK);  
.....

**Në nenin 63 të Kodit të Procedurës Penale (Kodi penal nr. 04/L-123) thuhet si në vijim:**

**Neni 63  
Përfaqësuesi i të dëmtuarit**

1. I dëmtuari mund të përfaqësohet nga përfaqësuesi i cili është anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës;
2. I dëmtuari mund të përfaqësohet nga mbrojtësi i viktimave;
3. I dëmtuari mund të përfaqësojë veten.

## LIGJI

47. Ankuesit pohojnë se EULEX-i ka shkelur të drejtat e tyre të mbrojtura me nenet 2 dhe 3 të Konventës. Në këto dispozita, për aq sa janë relevante, thuhet si në vijim:

### Neni 2 E drejta për jetën

1. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i merret jeta qëllimi, me përashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj.

...

### Neni 3 Ndalimi i torturës

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimive ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.

48. Përveç këtyre dispozitave, Paneli vendosi *proprio motu* që gjithashtu ta komunikoj dhe shqyrtoj lëndën sipas neneve 8 dhe 13 të Konventës, e cila thotë si në vijim:

### Neni 8 E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare

1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyr në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose përmbytjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.

### Neni 13 E drejta për zgjidhje efektive

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

## Parashtrimet nga palët

### *Shefi i Misionit (“ShM”)*

49. Në vërejtjet e tij rrëth meritave të lëndës, shefi i Misionit (ShM) ka adresuar pyetjen e Panelit nëse prokurorët e EULEX-it do të jetë kompetent për të ndjekur penalisht lëndët në bazë të “rrethanave të jashtëzakonshme” të nenit 7(A) të Ligjit të ndryshuar mbi kompetencat (vendimi mbi pranueshmëri, D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it, 2014-11, 2014-12, 2014-13, 2014-14, 2014-15, 2014-16 dhe 2014 -17, 30 shtator 2015 konkluzion). ShM-ja ka deklaruar se nocioni i “rrethanave të jashtëzakonshme” ishte dhënë hollësishët në Udhëzimin Administrativ në Prokurorinë Speciale të Kosovës lidhur me Përshkrimin dhe ndarjen e detyrave dhe mënyrën e bashkëpunimit ndërmjet Kryeprokurorit të PSRK-së dhe zëvendës shefit të prokurorit të PSRK-së (EULEX) dhe administrimin dhe menaxhimin e PSRK-së. Sipas nenit 4.4, ata i referohen:

“mosgatishmërisë apo paaftësisë nga ana e Prokurorit të Kosovës; ekspertizës dhe përvojës së prokurorit të EULEX-it do të sigurojë hetimin e duhur të ndjekjes penale të rastit në fjalë; ekziston dyshimi i bazuar i përpjekjeve për të ndikuar në hetimin apo ndjekjen penale; rasti nën hetim prek interesat e shteteve anëtare të BE-së apo të stafit të EULEX-it në Kosovë. “Nëse një person besohen se janë plotësuar kushtet e përcaktuara në nenin 7(A), ata duhet të adresojnë një kërkesë të hollësishme tek kryeprokurori i shtetit ose prokurori i EULEX-it, duke i theksuar rrethanat e pohuara të jashtëzakonshme. Vendimi për të zbatuar nenin 7(A) është marrë bashkërisht nga këta dy prokurorë dhe nuk është vetëm prokurori i EULEX-it që ka vendosur për të marrë përsipër lëndën.

50. ShM-ja ka përsëritur se lëndët 2014-11 dhe 2014-13 ishte mbyllur në vitin 2009, pasi ishin shqyrtuar nga EULEX-i dhe do të mund të rishikoheshin në qoftë se do të kishte informata të reja. Megjithatë, pasi që nuk ka pasur ndonjë informatë të tillë deri më tash, nuk ka pasur mundësi të merret parasysh zbatimi i nenin 7(A). Lidhur me pesë lëndët e tjera, ShM-ja thotë se ato kurrë nuk janë bartur në EULEX-it nga UNMIK-u. Për këtë arsyе prokurorët e EULEX-it nuk kanë qenë në dijeni për ekzistencën e tyre dhe nuk mund të pritet për të kryer ndonjë hetim në lidhje me krimet e pretenduara. Për më tepër, shumica e këtyre lëndëve në fjalë kanë ndodhur pas përfundimit të konfliktit dhe për këtë arsyе nuk mund të konsiderohen si kime të luftës. Prandaj ishte e pamundur që nenin 7(A) të mund të zbatohet.
51. ShM-ja ka sqaruar se pas përfundimit të mandatit të tij ekzekutiv UNMIK-u kishte transferuar dy të ashtuquajturat dosjet “aktive” (në lidhje me hetimet e vazhdueshme) dhe “pasive” në EULEX. Megjithatë dosjet në lëndët që para kësaj kanë qenë të ndërprera dhe/ose të hequra ose bartura nga UNMIK-u tek autoritetet e Kosovës nuk kishin arritur në EULEX. Prandaj fakti që EULEX-i nuk ka poseduar ndonjë dosje të caktuar për këtë arsyе nuk ka të bëjë me organizimin dhe punën e Misionit. Të gjitha dosjet e pranuara nga UNMIK ishte shqyrtuar nga prokurorët e EULEX-it, pavarësisht prej statusit të tyre.
52. ShM ka përfunduar se EULEX-i nuk i kishte shkelur të drejtat e ankuesve. Edhe pse ishte mandati i Misionit që të hetonte krimet e luftës dhe krimet e tjera të rënda, do të ishte joproportionale dhe joreale të pritej që të ndiqte penalisht dhe të zgjidhë të gjitha lëndët e tillë në pritje. Kjo nuk i binte EULEX-it që t'ju sigurojë të gjitha viktimave të kimeve që lidhen me konfliktin mjete efektive juridike ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre nga organizata të tjera ose autoritetet e Kosovës. Ai konsideron se EULEX-i ka trajtuar me kujdes të gjitha lëndët që i ishin dorëzuar nga UNMIK-u. Në lidhje me lëndët e tjera, Misioni nuk kishte kontroll dhe për këtë arsyе ato ishin jashtë përgjegjësisë së tyre.

## **Ankuesit**

53. Ankuesit kanë kundërshtuar interpretimin e "rrethanave të jashtëzakonshme" nga ShM-ja dhe duket se ka sugjeruar se interpretimi i këtij nocioni nga ShM në mënyrë efektive do të përbënte apo përfshinte shkelje të vazhdueshme të të drejtave të tyre sipas nenit 2. Për më tepër, ankuesit kanë treguar Opinionin e Panelit Këshillëdhënës të të Drejtave të Njeriut të UNMIK-ut në lëndën 2014-11, ku PKDNj-ja kishte gjetur se UNMIK-u i kishte shkelur të drejtat e mbrojtura të ankuesit të mbrojtura nga neni 2 i Konventës (shit par. 13 më lartë) dhe të cilat sipas pikëpamjes së tyre mund të konsiderohet se përbën "rrethanë të jashtëzakonshme" që duhej të kishte detyruar EULEX-in ta riapte hetimin e lëndëve të tyre.
54. Ankuesit kanë konkluduar se duke dështuar që të kryhej ndonjë hetim me vetë nismën e tyre apo atëherë kur janë shtyrë ta bënин atë, EULEX-i ka vazhduar të shkelte të drejtat e njeriut të ankuesve D.W. dhe F.V. Për më tepër, mungesa e dosjeve të lëndës që kishte të bënte me të katër lëndët e tjera, apo ndonjë tregues se hapat hetimorë ishin ndërmarrë dhe ndonjë tregues i qartë që EULEX-i nuk do të ndërmerrte ndonjë hap për të hetuar me vetë nismë ka përbërë shkelje të vazhdueshme të të drejtave të ankuesve të tjerë. Ankuesit kanë ftuar Panelin të konstatoj që EULEX-i kishte shkelur në mënyrë të vazhdueshme të drejtat e ankuesve të mbrojtura me nenet 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës.

## **Vlerësimi i Panelit**

### ***Shqyrtimet e përgjithshme ligjore***

55. Nuk ka sugjerime se veprat e përmendura të zhdukjes mund t'i atribuohen Misionit, Paneli nuk ka kompetencë që të konsideroj se kush mund të mbahet përgjegjës për këto vepra. E Paneli as nuk do të konsideroj dështimin fillestar të hapave hetimorë në lidhje me vdekjet e të afërme të aplikantëve që kanë ndodhur para formimit të EULEX-it Kosovë dhe që do t'i atribuoheshin të tjerëve (në veçanti UNMIK-ut). Për shkak të kufizimeve të përkohshme dhe substanciale rreth mandatit, Paneli mund dhe do të shqyrtoj vetëm ato veprime apo mosveprime që i atribuohen Misionit që prej se ka filluar të funksionoj (shih *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, vendim i pranueshëm i datës 30 shtator 2015, § 78; *Berisha kundër EULEX-it*, 2015-08, 1 mars 2016, § 14).
56. Paneli tanimë ka pasur rastin të theksohej se misioni i EULEX-it nuk është shtet dhe se aftësia e tij për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut nuk mund të krahasohen në të gjitha aspektet përkatëse të asaj që mund të pritet prej një shteti (PShDNj, *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11, 2014-12, 2014-13, 2014-14, 2014-15, 2014-16 dhe 2014-17, cituar më lartë, § 72; shih gjithashtu *L.O. kundër EULEX-it*, nr. 2014-

32, 11 nëntor 2015, § 42; krahasoni gjithashtu opinionin e PShDNj-së në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, § 35). Kjo është për shkak se Misioni nuk posedon të gjitha atributet dhe burimet që zakonisht janë në dispozicion të shtetit në kryerjen e funksioneve të tyre qeverisëse. Megjithatë në atë masë që Misioni ka mandatin dhe burimet përkatëse dhe të nevojshme për të përbushur një funksion të ngjashëm me atë të një qeverie, si pjesë e funksioneve ekzekutive, është e nevojshme për t'i kryer ato në përputhje me standardet e zbatueshme të të drejtave të njeriut.

57. Paneli gjithashtu vëren vështirësitë që domosdoshmërisht përfshihen në hetimin e krimeve të rënda në një shoqëri të pasluftës, siç është Kosova (shih Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, *Palic kundër Bosnjës dhe Hercegovinës*, nr. 4704/04, 15 shkurt 2011 § 70; *mutatis mutandis*; Opinion i PKDNj-së rreth lëndëve nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, të cituar më lartë, §§ 44) dhe 62 e tutje dhe opinionin e vet rreth lëndëve nr. 168/09, 169/09 dhe 312/09, 6 qershor 2013, § 77; PShDNj, *L.O. kundër EULEX-it*, cituar më lartë, § 44). Një situatë e tillë në të vërtetë mund të komplikoj kërkimin e dëshmive, mbrojtjen e dëshmitarëve ose kryerjen e detyrave të caktuara hetimore apo detyrat e mjekësisë ligjore. Fakti që një hetimi a ndjekja penale është duke u zhvilluar në një situatë pas konfliktit megjithatë nuk mund të shpjegojë secilën mangësi hetimore përvèç nëse ato kanë të bëjnë në mënyrë të arsyeshme me vështirësi të veçanta që lidhen me atë situatë. Prandaj në secilin rast Paneli vlerëson nëse ndonjë hap i veçantë hetimor që normalisht ishte i hapur do të ishte i pamundur apo jopraktik për arsyet që lidhen me rrethanat e pas konfliktit pavarësisht se kush e kryen hetimin.
58. Për më tepër, si Mision i sundimit të ligjit EULEX-i pritet që t'i kushtoj vëmendje të veçantë nevojës së rivendosjes, mirëmbajtjes dhe forcimit të sundimit të ligjit. Hetimi efektiv dhe ndjekja penale e krimeve të rënda është tipar veçanërisht i rëndësishëm i këtij aspekti të mandatit të EULEX-it. Prandaj është thelbësore që Misioni duhet të interpretoj kërkесат e "rrethanave të jashtëzakonshme" brenda kuptimit të nenit 7(A) të ligjit nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve (shih par. 9, 10 dhe 49 më lartë) në atë mënyrë që është në përputhje me përbushjen e këtij mandati. Ka pak dallim në mes të aftësisë së një shteti apo një Misioni të sundimit të ligjit për të vendosur sipas rëndësisë hetimin e krimeve të tilla dhe për t'i kushtuar kohë dhe burime të mjaftueshme këtij prioriteti operativ (shih *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, cituar më lartë, § 75; *L.O. kundër EULEX-it*, cituar më lartë, §§ 46-47).
59. Aktet e vrasjes së paligjshme përbëjnë ose përfshijnë shkelje të rënda të të drejtave të individit. Si rezultat i kësaj, viktimat e akteve të tilla në disa raste mund të thuhet se përfshinë jo vetëm viktimën e drejtpërdrejtë të veprës, por edhe të afërmit e atij individui (shih, p.sh., në lidhje me shkeljet e nenit 2, Mustafa-Sadiku kundër EULEX-it, lënda nr. 2014-41, 15 qershor 2015 § 14 dhe referencat e cituara aty;

shih gjithashtu, në kuadër të nenit 3 dhe lëndët që kanë të bëjnë me zhdukjet, GjEDNj-së, *Kurt kundër Turqisë*, vendimi i datës 25 maj 1998, Raportet e aktgjykimeve dhe vendimeve 1998- III, §§ 130-34, *Khadzhialiyyev dhe të tjerët kundër Rúsies*, nr. 3013/04, §§ 120-121, 6 nëntor 2008).

60. Për më tepër, neni 2 nuk ka të bëjë vetëm me vdekjet që rezultojnë prej përdorimit të forcës nga zyrtarët e shtetit (Sadik Thaqi kundër EULEX-it, 2010-02, 14 shtator 2011, § 69). Ajo gjithashtu përcakton një detyrim pozitiv mbi autoritetet për të ndërmarrë hapat e duhura për të mbrojtur jetën e atyre që janë brenda juridiksionit të tyre (shih për shembull, Mursel Hasani kundër EULEX-it, 2010-05, 14 shtator 2011, § 66, 69-70; shih gjithashtu GjEDNj-në, *L.C.B. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 9 qershor 1998 § 36, Raportet e Gjykimeve dhe Vendimeve 1998 III, dhe Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 46477/99, § 54, GjEDNj 2002-II), duke përfshirë edhe duke vendosur një kornizë ligjore projektuar për të siguruar parandalimin efektiv ndaj kërcenimeve të së drejtës për jetë në kontekstin e ndonjë aktiviteti, qoftë publike apo jo, në të cilën e drejta për jetë mund të jetë në rrezik (shih GjEDNj, në mesin e shumë autoriteteve të tjera *Zubkova kundër Ukrainës*, nr. 36660/08, § 35, 17 tetor 2013). Çfarëdo forme që merr hetimi, mjetet juridike në dispozicion duhet të jetë në gjendje që të vërtetojnë faktet, duke mbajtur përgjegjës ata që janë fajtor dhe duke ofruar kompensim të përshtatshëm (shih për shembull Sadik Thaqi kundër EULEX-it, 2010-02, 14 shtator 2011, §§ 69-70 dhe 95-101). Çfarëdo e mete në hetim që e démon ton aftësinë për të vendosur shkakun e vdekjes ose ata që janë përgjegjës për këtë, mund të çojë në gjetjen që kërkesat e Konventës nuk janë përbushur (shih GjEDNj, *Antonov kundër Ukrainës*, nr. 28096/04, § 46, 3 nëntor 2011).
61. Përfshirja e anëtarëve të familjes në hetimin e rasteve të tillë dhe mënyrën në të cilën autoritetet i përgjigjen pyetjeve të tyre mund ta rris stresin emocionale (shih *mutatis mutandis* GjEDNj *Orhan kundër Turqisë*, nr. 25656/94, § 358, 18 qershor 2002). Gjatë vlerësimit të përgjegjësisë së autoriteteve në lidhje me një rast të tillë, dobësia e kësaj kategorie të viktimate detyrimisht duhet të merret parasysh. Gjithashtu e rëndësishme në këtë kontekst është e drejta e viktimate të shkeljes të tillë të së vërtetës (shih p.sh. L. Joinet, Raportuesi Special, Raporti i rishikuar përfundimtar mbi pyetjen e mosndëshkimit të kryerësve të shkeljeve të të drejtave të njeriut (Civile dhe Politike); E/CN.4/Sub.2/1997-/20/Rev.1; 2 tetor 1997; GjEDNj *El-Masri kundër "ish-Republikës jugosllave të Maqedonisë"*, [GC], nr. 39630/09, §§ 191 dhe 193, GjEDNj 2012; Qipro kundër Turqisë, nr. 25781/94, GjEDNj 2001-IV; shih gjithashtu Këshillin e të Drejtave të Njeriut, E drejta për të vërtetën, A/HRC/12/L.27, 25 shtator 2009; Dhoma e të Drejtave të Njeriut për Bosnjë dhe Hercegovina, "Rastet e Srebrenicës", lënda nr. CH/01/8365, dhe të tjerë, Vendim mbi pranueshmëri dhe merita (7 mars 2003)).

62. Për rrjedhojë, reagimi i pritshëm i autoriteteve - në këtë rast Misioni - duhet të jetë në proporcion me peshën e shkeljes së pretenduar dhe rëndësinë e të drejtave të mbrojtura.
63. Pa dyshim, shumë vite pas ngjarjeve do të ketë vështirësi të konsiderueshme në mbledhjen e dëshmive apo në identifikimin dhe në ngritjen e rastit ndaj të pandehurve të dyshuar. Qëllimi esencial i hetimit të tillë është të sigurohet zbatimi efektiv i ligjeve vendore që mbrojnë të drejtën për jetën dhe ato raste që përfshijnë agjentët ose organet shtetërore për të siguruar llogaridhënien e tyre për vdekjet që ndodhin nën përgjegjësinë e tyre. Edhe aty ku mund të ketë pengesa të cilat pengojnë progresin në ndonjë hetim në një situatë të veçantë, reagimi në kohë dhe efektiv nga autoritetet është jetike për ruajtjen e besimit të publikut në respektimin e tyre të sundimit të ligjit dhe në parandalimin e çfarëdo paraqitjeje të veprimeve apo tolerimit të veprimeve të paligjshme (shih *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 16064/90 dhe të tjerë, 18 shtator 2009 § 191; *McKerr kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 28883/95, §§ 111 dhe 114, GjEDNj 2001-II; *Brecknell kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 32457/04, § 65, 27 nëntor 2007; *L.O. kundër EULEX-it*, cituar më lartë, § 46).
64. Paneli thekson se një angazhim i rreptë dhe zbatimi i këtyre standardeve është veçanërisht i rëndësishme për Misionin e sundimit të ligjit siç është EULEX-it, i cili ka për qëllim të shërbejë si shembull i përkushtimit të shoqërisë për t'i dhënë fund mosndëshkimit dhe për ndërtimin e një ndjenjë të fortë të përgjegjësisë lidhur me shkeljet serioze të të drejtave të njeriut. Çfarëdo standardi më pak se kjo do të përbente rrezik duke krijuar një ndjenjë të pajtimin me mosndëshkimin dhe mospërfilljen ndaj kërkeseve legitime të viktimateve për drejtësi dhe llogaridhënie (shih vendimin e PKDNj-së në rastet nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, cituar më lartë, § 80). Nga ana tjetër, kjo mund të përbëjnë ose të përfshijë një shkelje të vazhdueshme të të drejtave. Me fjalë të tjera, shkelja e të drejtave themelore të personave të zhdukur (dhe të të afërmve të tyre) vazhdon deri në atë moment kur autoritetet të përbushin detyrimet e tyre hetimore.
65. Në kryerjen e këtyre detyrave hetimore, autoritetet kanë obligim të përgjithshëm për kujdes dhe shpejtësi. Në secilin rast, autoritetet hetimore priten të veprojnë me arsy, menjëherë, me shpejtësi dhe për të vënë burime gjegjëse me nevojën dhe mundësinë e zgjidhjes së çështjes në fjalë. (Mendimi i PKDNj-së në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, të cituar më lartë, § 80; PShDNj, *Maksutaj kundër EULEX-it*, 2014-18, 12 nëntor 2015, § 56). Për të përbushur këtë nevojë për kujdes, përpjekja hetimore në të gjitha rastet duhet të drejtohen në trajtimin e fakteve dhe rrethanave që rezultuan ose kontribuan në shkeljen e një të drejte. Një hetim që do të dështonte t'i adresoj këto dhe nëse nuk përqendrohet ngushtë në një aspekt të rastit ose në çështje të parëndësishme ose në mënyrë të pashpjegueshme nuk adreson përgjegjësinë e individëve të caktuar, në parim nuk e plotëson këtë kërkësë (shih p.sh. A, B, C, D kundër EULEX-it nr. 2012-09 deri në 2012-12, 20 qershori 2013 §§ 66-67).

Për të plotësuar atë standard, hetimi duhet të përfshijë edhe hapa të tillë që kanë mundësi t'i vërtetojnë faktet relevante dhe sipas rastit t'i identifikoj personat që mund të jenë përgjegjës për shkeljen e të drejtave. Hapat e ndërmarrë duhet të pasqyrojë "një përpjekje të vërtetë, në bazë të materialit ekzistues hetimor [...] për të përcaktuar faktet relevante dhe identifikuar personat [...] përgjegjës për [dëmin e shkaktuar]" (për ilustrim, shih PShDNj, *Thaqi kundër EULEX-it*, 2010-02, 14 shtator 2011, § 98; shih gjithashtu GjEDNj, *Velcea dhe Mazare kundër Rumanisë*, nr. 64301/01, § 105, 1 dhjetor 2009).

*Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e lëndëve 2014-12, 2014-14, 2014-15, 2014-16 dhe 2014-17*

66. Paneli së pari do t'iu kthehet lëndëve për të cilat EULEX-i argumenton se ato kurrë nuk kanë arritur tek organet hetimore të saj (nr. 2014-12, 2014-14, 2014-15, 2014-16 dhe 2014-17).
67. Me trajtimin e çështjes së pranueshmërisë së këtyre lëndëve, ShM-ja ka pohuar se prokurorët e EULEX-it asnjëherë nuk kanë pasur kompetencë për t'i hetuar këto lëndë, ku dosja e lëndës zyrtarisht nuk ka mbërritur tek ta. Paneli është i mendimit se ky pozicion duhet të refuzohet për dy arsyet kryesore.
68. Së pari, është përgjegjësi e Misionit për të siguruar organizimin e vet në atë mënyrë që të garantoj mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv (*D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, cituar më lartë, § 89). Asnjë argument nuk është dhënë për të shpjeguar se si bartja e dosjeve të hetimeve penale nga UNMIK-u tek EULEX-i është kryer në lidhje me personat që ishin subjekt i vrasjeve të paligjshme ose që janë zhdukur gjatë konfliktit ose menjëherë më pas nga UNMIK-u tek EULEX-i. E as nuk ishte shpjeguar se çfarë hapa ishin ndërmarrë me qëllim të mbrojtjes së të drejtave procedurale të viktimateve të veprave të supozuara; ndër të tjera, përfshirë përmes regjistrimit të duhur të të gjitha dosjeve të bartura.
69. Së dyti, mbrojtjen efektive e këtyre të drejtave nuk mund të varet nga marrëveshja e veçantë e bërë nga UNMIK-u dhe EULEX-i në lidhje me bartjen e dosjeve të lëndës. Në lëndët nën shqyrtim e sipër, Misioni është informuar rregullisht nga ankuesit për ekzistencën e lëndëve të tilla. Përgjegjësia e Misionit për të hetuar këto raste nuk ishte dhe nuk mund të varej nga parashtrimi formal i një dosje të "gjallë" të lëndës nga UNMIK-u. Është përgjegjësia e vetë Misionit që të shqyrtoj në mënyrë efektive dhe të hetoj këto raste, sidomos kur vepra të rënda të tilla si ato në këto lëndë janë sjellë në vëmendjen e tij (*D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, cituar më lartë, § 89).
70. Arsyetimi i mësipërm vlen për këtë fazë të procedurës. Paneli gjithashtu thekson se prokurorët e EULEX-it kanë për detyrë të

veprojë *proprio motu* në hetimin e rasteve që hyjnë brenda kompetencave të tyre dhe se detyra e tyre për të vepruar nuk lidhet me atë që ata të njoftohen nga dikush ose të marrin informata nga ndonjë burim tjetër (shih, për shembull, D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it, cituar më lartë, § 97).

71. Për më tepër, fakti që një mision më herët (UNMIK-u) ka "mbyllur" një rast apo ka shpallur atë "joaktiv", nuk e shkarkon EULEX-in nga detyrimet e tij procedurale. Paneli është i mendimit se, si në rastin në fjalë, kur vëmendja e Misionit është tërhequr në çështjet e mundshme të të drejtave të njeriut në hetimin e një çështjeje që ngritët në lidhje me veprat penale të rënda të pretenduara, Misioni mundet të pritet që të shqyrtojë me kujdes të dhënët e atij rasti për të kryer vlerësimin e vet për përputhshmérinë e këtij hetimi me standardet procedurale të ligjit të të drejtave të njeriut.
72. Paneli tashmë ka konstatuar se një person që pretendon ndonjë shkelje të këtij lloji nuk mund të pritet që të kryej hetimin e rastit nga vetë ai/ajo, e as nuk duhet që ai/ajo të jetë e nevojshme të troket në dyert e institucioneve të ndryshme me shpresën e gjetjes së ndonjë autoriteti që mund të jetë përgjegjës për hetimin e rastit (shih gjithashtu L.O. kundër EULEX-it, nr. 2014-32, 11 nëntor 2015 § 63). Për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut në rastet që ngritin çështjet sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës, është e domosdoshme që përgjegjësia për të bashkërenduar përpjekjet hetimore (dhe prokuroriale) mbetet në vetë autoritetet. Ata, jo të afërmit e viktimave, mbajnë përgjegjësinë për të siguruar efektivitetin e të drejtave të atyre që kanë vuajtur dëmet.

*Zbatimi i parimeve të përgjithshme për rrethanat e rasteve 2014-11 dhe 2014-13*

73. Në rastin konkret, vëmendja e Misionit ishte tërhequr nga ankuesit në vdekjen e të afërmve të tyre. Veprimet e ndërmarra nga Misioni në lidhje me këtë informacion ishin të kufizuara në kontrollimin nëse dosjet ishin në posedim të EULEX-it si rezultat i bartjes së dosjeve të saja nga ana e UNMIK-ut dhe në informimin e ankuesve se nuk ishte ashtu. Aplikantët ishin informuar se në mungesë të dosjeve të tillë, EULEX-i nuk do të merr ndonjë masë hetimore. Në numrat e lëndëve 2014-14, 2014-15, 2014-16 dhe 2014-17 asnjë hap nuk duket se është ndërmarrë me qëllim që të përcaktohet nëse dosjet e hetimit duhej të gjendeshin tek autoritetet e Kosovës. Asnjë shpjegim rrëth kësaj nuk i është ofruar Panelit. Në lëndën 2014-12 ankuesi nuk ka marrë asnjë përgjigje në lidhje me thelbin e rastit të saj me përfashtim të informacioneve që ajo nuk mund të përfaqësojë veten, pasi ajo duhej të përfaqësohej nga një avokat, anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës.
74. Në lidhje me të dy rastet kur hetimi ishte zhvilluar (nr. 2014-11 dhe 2014-13), Paneli përsërit se hapat hetimore duhet të jetë

proporcionale në natyrë me peshën e shkeljes së pretenduar (*Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë* [GC], cituar më lartë, § 191; *Palic kndër Bosnie dhe Hercegovinës*, cituar më lartë, § 63, *L.O. kundër EULEX-it*, cituar më lart, § 59). Kjo ka të bëjë me afatet kohore të reagimit të autoriteteve, burimet e caktuara për këtë çështje dhe me përpikërinë që ata mund të pritet për të vepruar. Në një rast të tillë si këto ku ka një pretendim të besueshme se të drejtat e rëndësishme themelore janë shkelur, ekziston një priti që autoritetet hetimore do të veprojë menjëherë në fillimin, kryerjen dhe përfundimin e hetimit të tyre dhe se në këtë proces ata do të marrin të gjitha masat e arsyeshme në dispozicion për t'i vërtetuar rrethanat në të cilat kanë ndodhur këto shkelje (shih për shembull PShDNj, *L.O. kundër EULEX-it*, lënda nr. 2014-32, Vendimi dhe Gjetjet, 11 nëntor 2015, par. 46; shih gjithashtu PKDNj në lëndën nr. 52/09, cituar më lartë, §§ 46-49).

75. Paneli më tej thekson se efektiviteti i një hetimi në këtë lloj rrethanash bën të domosdoshme që autoritetet t'i mbajnë viktimat apo të afërmít e tyre, siç mund të ngjet, të informuar rreth rrjedhës së përgjithshme të hetimit dhe të trajtohen kërkesat e tyre për informacion me maturi dhe zell të nevojshëm (shih për shembull *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, 11 nëntor 2015; Desanka dhe Zoran Stanishiq kundër EULEX-it, 2012-22, 11 nëntor 2015; Mendimi i PKDNj-së në lëndët nr. 168/09, 169/09 dhe 312 / 09, të cituar më lartë, § 89-90, Mendimi i PKDNj-së në lëndët 02/09, 6 dhjetor 2012, § 84). Një shkallë e transparencës dhe sinqeritetit në kontekst të tillë do të sigurojë që lënda e paditësit ishte trajtuar në mënyrë të drejtë, me zell dhe në mënyrë efektive (*Desanka dhe Zoran Stanisić kundër EULEX-it*, 2012-22, 11 nëntor 2015 § 69).
76. Është vërejtur më tej se detyrimet ndaj të drejtave të njeriut të vëna mbi autoritetet sipas nenit 3 të Konventës janë të ndryshme nga detyrimi që del nga neni 2 i Konventës, si në substancë po ashtu edhe në shtrirjen e tij kohore. Ka një shkallë të ngashshmërisë midis dy detyrimeve që të dytë nuk janë obligim i rezultatit, por i mjeteve. Megjithatë përderisa obligimi procedural sipas nenit 2 kërkon që autoritetet të marrin veprim të veçantë ligjor që është në gjendje të çojnë në identifikimin dhe dënimin e personave përgjegjës, detyrimi i vënë nga neni 3 është i një natyre më të përgjithshme humanitare, sepse urdhëron autoritetet të reagojnë ndaj gjendjes së të afërmve të personit të vdekur në një mënyrë humane dhe të dhembshur. Autoritetet kanë për detyrë t'i përbahen kërkesave të nenit 3, pavarësisht nëse ata ishin përgjegjës për aktin e parë të vdekjes apo zhdukjes (shih Açısh kundër Turqisë, nr. 7050/05, §§ 36 dhe 51 54, 1 shkurt 2011).
77. Në këtë lëndë, Paneli konstaton se nuk është argumentuar, e lëre më treguar që para vendimeve për të hequr kallëzimet penale të lëshuara në vitin 2009 (shih në veçanti par. 16-17, 23, 30-31 më sipër), ishte ndërmarrë ndonjë hap për të marrë deklaratat e dëshmitarëve nga prokurorët e EULEX-it. Po ashtu Paneli nuk ka ndonjë tregues të

linjave të hetimit, nëse ekzistojnë, që janë ndjekur në këto dy raste, ose që çfarë përpjekje janë ndërmarrë për t'u përpjekur që të identifikohen të dyshuarit. Nuk ka pasur asnjë përpjekje për të kontaktuar ankuesit apo të afërmit e viktimate për të verifikuar nëse ata kishin informacionin e duhur në lidhje me rastet. Paneli nuk ka marrë asnjë tregues se kjo është bërë dhe të nxjerr konkluzione të nevojshme nga mungesa e një informacioni të tillë (krahaso Mendimin e PKDNj-së në lëndën nr. 52/09, cituar më lartë, §§ 46-49). Për më tepër, nuk është kontestuese se vendimet e dhëna në vitin 2009 asnjëherë nuk ju ishin komunikuar zyrtarisht ankuesve.

78. Për më tepër, Paneli ka theksuar sugjerimin nga prokurori i EULEX-it se ankuesit nuk mund të veprojnë nëse nuk përfaqësohen nga anëtarët e Odës së Kosovës (shih më lartë). Paneli nuk duhet të vendosë nëse neni 63(1) i KPP-së ishte me të vërtetë i zbatueshëm për kjo çështje apo nëse ishte zbatuar siç duhej. Megjithatë duhet të theksohet se paragrafi 2 i kësaj dispozite do të kishte dhënë një bazë të mjaftueshme ligjore për prokurorin që t'i konsideroj përfaqësuesit e ankuesve si të autorizuar për t'i përfaqësuar ata. Si alternativë, prokurori i EULEX-it mund të kishte trajtuar kërkesën sikur të ishin bërë nga vetë ankuesit sipas neni 63(3) të KPP. Për më tepër, teksti i kësaj dispozite parashikon shprehimisht se një viktimë "mund" të përfaqësohet ashtu që Kodi nuk e trajton përfaqësimin ligjor si kusht të domosdoshëm (siç është po ashtu e dukshme nga paragrafi 3 i kësaj dispozite). Paneli më tej pohon se përgjigjet e gjykatës të dhëna ankuesve nuk kanë arritur të marrin parasysh natyrën serioze të situatave në fjalë, stresin dhe ankthin e ankuesit. Nuk është ofruar asnjë shpjegim për këtë qasje tepër formale dhe të pandjeshme. Një qasje e tillë nuk i plotëson standardet dhe pritet e zbatueshme në këtë çështje (shih p.sh., *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, 11 nëntor 2015; *Desanka dhe Zoran Stanishic kundër EULEX-it*, 2012-22, 11 nëntor 2015, sipas mendimit të PKDNj-së në lëndët nr. 168/09, 169/09 dhe 312/09, të cituar më lartë, § 89-90, Mendimi i PKDNj-së në lëndën 02/09, 6 dhjetor 2012, § 84). Nuk është ofruar asnjë shpjegim për këtë qasje tepër formale dhe të pandjeshme.
79. Më në fund, Paneli vëren se kompetenca dhe përgjegjësia e EULEX-it për të hetuar krimet që janë brenda mandatit të vet nuk janë të kushtëzuara nga veprimet e palës së dëmtuar. Në një rast të tillë si ky, EULEX-i është përgjegjës për të vepruar *proprio motu* me qëllim që të sigurohet se zhdukja është duke u hetuar me zell, menjëherë dhe në mënyrë efektive. Në përputhje me rrethanat një refuzim i kërkesave të ankuesve për informacion në asnjë mënyrë nuk ka prekur obligimet e Misionit *proprio motu* për të garantuar efektivitetin e të drejtave të tyre themelore (shih në mesin e shumë autoriteteve të tjera, *Ahmet Özkan dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 21689/93, § 310, 6 prill 2004; *Isayeva kundër Rúsisë*, nr. 57950/00, § 210, 24 shkurt 2005).
80. Në këto rrethana, Paneli konkludon se përgjigja e EULEX-it ndaj kërkesave të ankuesit, në veçanti letrat e datës 12 korrik 2013 (shih

par. 20 dhe 28 më lartë) ka qenë jo adekuate. Përpjekjet e tyre kanë rezultuar vetëm në marrjen e informacionit minimal dhe vetëm atëherë kur kanë bërë presion për përgjigje.

## PËRFUNDIM

81. Bazuar në atë që u përmend më sipër, Paneli konstaton se përpjekjet hetimore të EULEX-it ishin të pamjaftueshme dhe ka rezultuar në shkelje të të drejtave të ankuesve të garantuara me nenet 2 dhe 3 të Konventës në lidhje dhe me nenin 13 në lidhje me nenin 2 të Konventës.
82. Duke pasur parasysh konstatimet e veta në lidhje me nenet 2, 3 dhe 13 të Konventës, Paneli konsideron se nuk është e nevojshme për të shqyrtuar çështjen edhe në bazë të nenit 8 të Konventës.

### *Zbatueshmëria e nenit 7(A) e Ligjit mbi kompetencat*

83. Paneli tani do të shqyrtojë nëse Misioni ka mbetur kompetent për të hetuar këto lëndë pas ndryshimit të nenit 7(A) të Ligjit mbi Juridikcionin dhe nëse po a mund të mbahet përgjegjës për dështimin për të vepruar pas asaj (në veçanti shih par. 9-10 dhe 49 më lartë).
84. Siç është cekur nga Paneli në një rast të mëparshëm, neni 7 (A) i Ligjit nr. 04/L-273 i jep prokurorisë së EULEX-it mundësinë për të bërë përashtim nga parimi i përgjithshëm se lëndët të cilat nuk janë konsideruar lëndë në vazhdim e sipër nga data 14 prill 2014 do të trajtohen nga autoritetet e Kosovës (krahasuar, X dhe 115 ankues të tjera kundër EULEX-it, 2011-20, § 64). Kjo dispozitë nuk mund të rezultojë në pengimin apo kualifikimin e përgjegjësisë së Misionit për të vepruar në çdo kohë në përputhje me standardet e të drejtave të rëndësishme të njeriut (shih p.sh. H&G kundër EULEX-it, 2012-19 dhe 2012-20, 30 shtator 2013, §§ 41 e tutje).
85. Në mesin e shqyrtimeve përkatëse për ekzistencën e “rrethanave të jashtëzakonshme” janë këto: së pari, nëse një hetim efektiv i lëndës është kryer deri në atë pikë. Përgjigja negative do të shkonte në favor të prokurorëve të EULEX-it që të ushtronin kompetencat e tyre “të jashtëzakonshme”. Në rastin në fjalë, Paneli tashmë ka gjetur se lëndët nuk kanë qenë asnjëherë objekt i një hetimi të plotë dhe efektiv për ndonjë periudhë të konsiderueshme kohore nga ndonjë organ. Së dyti, është e rëndësishme nëse lënda ka të bëjë me të drejtat e rëndësishme dhe shkeljet e rëndësisë së lartë. Këto konsiderata të tillë përsëri do të peshojnë në favor të përfshirjes së “jashtëzakonshme” të prokurorëve të EULEX-it. Lëndët në shqyrtim këtu kanë të bëjnë të gjitha me një sërë të të drejtave themelore, duke përfshirë të drejtën për jetën. Gjithashtu, ka pasur një mundësi shumë reale se këto krime dhe shkelje përcjellëse të të drejtave janë bazuar në faktorët etnik apo fetar duke shkuar më tej në terrenin e juridikcionit mbi të cilin Misioni ka kompetencë. Në një mjedis pas

konfliktit ku marrëdhëniet etnike dhe fetare mund të jetë ende të tensionuara dhe të brishta, lëndët e tillë janë prioritete të dukshme hetimore. Prapë nga të dhënat kjo nuk duket se është konsideruar e rëndësishme për përcaktimin nga ana e Misionit e "rrethanave të jashtëzakonshme". Së treti, nëse prokurorët e EULEX-it nuk vendosin të ushtrojnë kompetencat e tyre "të jashtëzakonshme", a ka ndonjë mundësi të vërtetë dhe reale që autoritetet vendore të kryejnë përgjegjësinë e tyre në lidhje me këtë rast. Në rastin konkret, nuk ka asnjë tregues se do të jetë kështu ose që është ndërmarrë ndonjë hap në mënyrë që të përcaktohen faktet relevante për ekzistencën e një mundësie e tillë (shih gjithashtu X dhe 115 ankues të tjerë, § 66).

86. Ligji i jep autoritetit të prokurorisë së EULEX-it kompetencë diskrecionale për t'i marrë përsipër lëndët që ata i konsiderojnë për nga natyra të jashtëzakonshme. Kjo nuk i takon Panelit ta zëvendësoj autoritetin e EULEX-it që të zbatoj atë kërkесë. Megjithatë, diskrecioni i Misionit në këtë drejtim nuk mund të ushtrohet në mënyrë arbitrale ose pa marrë në konsideratë të gjithë faktorët dhe rrethanat përkatëse. Ajo duhet të ushtrohet në një mënyrë që është në përputhje me mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut. Në këtë rast, nuk është argumentuar e lëre më treguar se shqyrtimi i duhur nga ana e EULEX-i ishte përqendruar në pyetjen nëse rrethanat e rasteve (siç përshkruhet më sipër) kanë bërë të nevojshëm cilësimin e tyre si "të jashtëzakonshme" për qëllimet e këtij statuti.
87. Bazuar në atë që u përmend më sipër, Paneli është i bindur që, *prima facie*, lëndët mund të ketë hyrë në kuptimin e frazës "rrethana të veçanta" të nenit 7(A) të Ligjit të ndryshuar mbi Kompetenca dhe se Misioni për këtë arsyе do të kishte mbetur kompetent në parim për t'i hetuar ato pas ndryshimit të Ligjit mbi Kompetencat. Për këto arsyе, Paneli konstaton se shkelja e të drejtave të ankuesve nga Misioni ka vazhduar edhe pas ndryshimit të Ligjit për shkak të mos shqyrtimit të këtyre lëndëve në bazë të kësaj dispozite.

### **PËR KËTO ARSYE, PANELI, NJËZËRI,**

1. Konstaton se ka pasur shkelje të neneve 2 dhe 3, dhe nenit 13 në lidhje me nenin 2 të Konventës.
2. Gjen të përshtatshme, në dritën e gjetjeve të tij të mësipërme të fakteve dhe ligjit që të bëjë rekomandimet e mëposhtme për shefen e Misionit sipas Rregullës 34 të Rregullores së punës:
  - a. ShM-ja duhet të bëjë një deklaratë që pranon se rrethanat e rastit kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankueses, që i ngarkohen veprimeve [dhe/ose mosveprimeve] të EULEX-it gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv;

- b. ShM-ja duhet t'ju komunikojë dhe transmetojë këtë vendim të gjitha organeve përkatëse hetimore dhe prokuroriale të Misionit.
- c. Duke vepruar këtë, ShM-ja duhet t'i udhëzoj të gjitha organet e Misionit që janë në kontakt me viktimat e shkeljeve të pretenduara të të drejtave të njeriut të garantuara me nenet 2 dhe 3 të Konventës në kuadër të zhdukjeve të detyruara për të siguruar që në të gjitha komunikimet me ta, ata të komunikojnë me shpejtësinë, zellin e duhur dhe kujdesin e nevojshëm, për të marrë parasysh shqetësimin emocional të bashkëbisedues(ve)it të tyre. Nëse është e nevojshme, ShM-ja duhet të konsideroj zbatimin e udhëzimeve të cilat përcaktojnë në mënyrë më të hollësishme se çfarë mund të nënkuptojnë ky udhëzim i përgjithshëm në rrethana konkrete.
- d. ShM-ja duhet t'i udhëzoj organet hetimore të EULEX-it mbi rëndësinë e rasteve të zhdukjeve që vazhdojnë të jenë prioritet i hetimeve në mënyrë që ato të hetohen plotësisht dhe në mënyrë efektive dhe se kudo që të dyshuarit të identifikohen të sillen para drejtësisë menjëherë dhe në mënyrë të drejtë.
- e. Më tej ShM-ja ftohet që autoritetete kompetente hetuese dhe prokuroriale në kuadër të Misionit t'i tjerq vëmendjen kah faktorët e cekur më sipër si relevante për kompetencat e "jashtëzakonshme" të prokurorëve të EULEX-it dhe për t'i njojur ata me rëndësinë e marries parasysh të këtyre faktorëve në vlerësimin e tyre nëse duhet që ata të kërkojnë të marrin përsipër përgjegjësinë mbi këtë lëndë. Paneli pret që do të bëhet një shqyrtim i këtyre lëndëve në bazë të këtyre parametrave në mënyrë që të sigurohet se autoritetet hetimore dhe prokuroriale do të marrin një vendim të mirëinformuar dhe ligjërisht të arsyeshëm në lidhje me nevojën për të hetuar disa apo të gjitha këto lëndë.
- f. Paneli është plotësisht i vetëdijshëm për sfidat dhe vështirësitë që rezultojnë nga reduktimi i burimeve të Misionit për shkak të rikonfigurimit. Megjithatë, brenda kufijve të këtyre burimeve dhe në mënyrë proporcionale me rëndësinë që Mision i jep mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut, Paneli fton ShM-në të siguroj që organet hetuese brenda Misionit të kenë në dispozicion të gjitha burimet e nevojshme dhe mbështetjen për të përbushur misionin e tyre në mënyrë efektive dhe në përputhje me mbrojtjen

efektive të të drejtave të njeriut të të gjithë të përfshirëve.

Ftohet ShM-ja që të informoj Panelin rreth masave që ka ndërmarrë ajo në lidhje me këtë vendim deri me datën 19 nëntor 2016.

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese

